Bazuar në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, neni 75 dhe VKA nr. 5, datë 14.08.2020 "Për shtesa e ndryshime në Rregulloren nr. 3/2, datë 26.02.2008 "Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore" dhe sipas **Urdhrit Nr. 136/1 Prot., datë 09.10.2026** të Drejtorit Rajonal të Sigurimeve Shoqërore Vlorë "Për hapjen e procedurës së rekrutimit të personelit nëpërmjet konkurimit të hapur", Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë, shpall vend të lirë pune për pozicionin:

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore VLORË

Dega e Administrimit të Përgjithshëm dhe Shërbimeve

- Sekretar i Drejtorit

1 (një) vend pune

Kandidatët konkurues :

- Duhet të zotërojë diplomë Universitare të Nivelit të Parë / Bachelor të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të Arsimit të Lartë.

Kërkesat e përgjithshme specifike

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që lejojnë të kryejnë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore të largimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore, shërbimi civil ose administrata publike, që nuk është shënuar, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim & intervista

- Njohuri në fushën e Sigurimeve Shoqërore (Statuti i ISSH, Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar).
- Njohuri të Rregulloreve Financiare, të Përfitimeve, të Kontributeve dhe për sistemin e informacionit të ISSH;
- Njohuri të Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat";
- Njohuri të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë;
- Njohuri të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 **"**Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike"; Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike";

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Në vlerësimin e kandidatëve përfshihen :

- vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën;

- vlerësimi me shkrim, që konsiston në vlerësimin e njohurive për legjislacionin e zbatueshëm për sigurimet shoqërore, organizimin administrativ në sistemin e sigurimeve shoqërore, për nivelin e njohurive akademike dhe profesionale, bazuar në kriteret e përcaktuara;
- intervista me gojë ku zhvillohet intervistimi i kandidatëve, i cili synon të evidentojë formimin e përgjithshëm, si dhe vizionin e tyre mbi veprimtarinë e sigurimeve shoqërore dhe për pozicionin që konkuron.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:
- për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, **deri në 20 pikë**;
- për intervistën me gojë, **deri në 40 pikë**;
- për vlerësimin me shkrim, **deri në 40 pikë**.
- Kandidatët konkurues kualifikohen nëse në total ka fituar **mbi 70 pikë,** nga 100 pikë të mundëshme, gjatë fazës së vlerësimit

Numri minimal i konkurrentëve, që kalojnë në fazën e vlerësimit të kandidatëve, duhet të jetë jo më pak se tre kandidatë për pozicionin. Në rast mosplotësimi të numrit të domosdoshëm të kandidatëve konkurues në fazën e vlerësimit, Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm merr masa për anulimin e procedurës së konkurimit dhe njofton kandidatët.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit
- Një kërkesë për konkurim për pozicionin e punës për të cilin është i interesuar.
- Një kopje e jetëshkrimit (CV);
- Fotokopje e diplomës dhe listës së notave (e noterizuar);
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga prokuroria dhe gjykata
- Raport të aftësisë për punë
- Fotokopje e librezës së punës;
- Certifikatë ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
- Fotokopje e Kartës së Identitetit

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet brenda datës 26.10.2026, pranë zyrës së protokoll / sekretarisë në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më lart.

Testimi me shkrim, do të zhvillohet në ambjentet e DRSSH Fier, në datën **02.11.2026**, **ora 10:00**

Intervista me gojë, do të zhvillohet në ambjentet e DRSSH Fier, në datën **03.11.2026, ora 10:00**